



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 95

Tiranë – E mërkurë, 10 qershor 2015

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 52/2015 datë 14.5.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin, nga llogaria EU/IPA e <i>by-pass</i> -it Vlorë, për <i>by-pass</i> -in e Vlorës.....
Ligj nr. 53/2015 datë 21.5.2015	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar.....
	Ndreqje gabimi.....
	4995
	5011
	5011



**LIGJ**  
**Nr. 52/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
SË GRANTIT NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
BANKËS EUROPIANE PËR  
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR  
INVESTIMIN, NGA LLOGARIA EU/IPA  
E *BY-PASS*-it VLORË, PËR *BY-PASS*-in E  
VLORËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për investimin, nga llogaria EU/IPA e *by-pass*-it Vlorë, për *by-pass*-in e Vlorës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.5.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9120, datë 27.5.2015,  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

9 korrik 2014

(Numri i operacionit: 42319)

**MARRËVESHJE GRANTI**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE**  
**PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, NË**  
**LIDHJE ME GRANTIN E INVESTIMIT**  
**NGA LLOGARIA E EU/IPA-së PËR *BY-***  
***PASS*-in E VLORËS**

Datë [data]

Kjo Grantmarrëveshje (Marrëveshja) është lidhur në (data) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (më poshtë e quajtur “Marrësi”), e

përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (më poshtë e quajtur “Banka” ose “BERZH”).

Duke marrë parasysh se:

A. BERZH-i është një institucion financiar ndërkombëtar i ngritur sipas ligjit ndërkombëtar mbi bazën e të cilit është krijuar Marrëveshja që themelon Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Marrëveshja që ka themeluar Bankën), e datës 29 maj 1990, e ndryshuar.

B. Në datën 24 nëntor 2011, Banka hyri në një marrëveshje huaje me Marrësin, në cilësinë e tij si Huamarrës, sipas së cilës Banka, si huadhënëse, ka rënë dakord të japë një hua deri në 53.000.000 euro (pesëdhjetë e tre milionë) për financimin e një pjese të Projektit, siç përshkruhet në pasqyrën 2 (më poshtë i quajtur “Projekti”), në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuar në marrëveshjen e huas, këto marrëveshje huaje që mund të ndryshohen herë pas here (Marrëveshja e Huas).

C. Në bazë të nenit 20 të Marrëveshjes që ka themeluar Bankën, kjo e fundit është e autorizuar të lidhë dhe të administrojë marrëveshjet e bashkëpunimit me çdo ent publik apo privat. Në vijim të sa më sipër, Banka dhe Bashkimi Evropian lidhën një marrëveshje, IPA 2011 - Ndërtimi i *by-pass*-it të Vlorës, e datës 13 dhjetor 2012, siç mund të ndryshohet herë pas here (Marrëveshja e *by-pass*-it të Vlorës IPA), sipas së cilës Banka menaxhon dhe administron fonde bashkëpunimi të vëna në dispozicion nga Bashkimi Evropian në një llogari bankare (llogaria e *by-pass*-it të Vlorës IPA).

D. Banka ka rënë dakord të vërë në dispozicion për Marrësin grante nga llogaria e *by-pass*-it të Vlorës IPA, grant i cili u nënshtrohet termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Për këto arsye, është rënë dakord si më poshtë:

**Neni 1**

**Përkufizimet, referencat dhe kryetitujt**

Seksioni 1.01. Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet me germa kapitale në këtë Marrëveshje (duke përfshirë deklaratimet e veçanta dhe pasqyrat), por jo të përcaktuara në kontratë, do të kenë kuptimin e dhënë atyre në



Marrëveshjen e Huas, dhe/ose në Termat dhe Kushtet Standardë kur përdoren në këtë Marrëveshje.

Kurdo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë pasqyrat, deklaratimet dhe pikat specifike), nëse konteksti nuk kërkon ndryshe, termat e mposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

“Marrëveshja që ka Themeluar Bankën” ka kuptimin që i është dhënë në pikën A.

“Autoriteti Rrugor Shqiptar” ose ARRSH-ja nënkupton agjencinë ekzekutive për këtë projekt në emër të Republikës së Shqipërisë.

“Kontrata” nënkupton kontratat në fuqi ose që duhet të lidhen ndërmjet ARRSH-së dhe Kontraktorëve, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, në lidhje me prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të lidhura me to për Projektin, duke përfshirë Objektet e Financuara nga Granti, dhe që duhet të financohen tërësisht ose pjesërisht nga Granti i *by-pass*-it të Vlorës IPA.

“Kontraktorët” nënkupton kontraktorët që kanë përmbushur detyrimet dhe kanë reputacion të mirë, për t’u kontraktuar nga ARRSH-ja në lidhje me prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të lidhura me to, për Projektin, duke përfshirë Objektet e Financuara nga Granti, me çdo kontraktor të tillë dhe Kontraktori duhet të zgjidhet në përputhje me seksionin 3.05 (Prokurimi).

“Disbursimi” nënkupton disbursimin e çdo sasive nga Granti i *by-pass*-it të Vlorës IPA, herë pas here, në bazë të seksionit 2.02 (Disbursimet) e kësaj Marrëveshjeje.

“Donatori” nënkupton Bashkimin Evropian.

“Data e hyrjes në fuqi” nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi në përputhje me seksionin 7.01 (Data e hyrjes në fuqi).

“Granti” nënkupton Grantin e *by-pass*-it të Vlorës IPA.

“Zërat e Financuar nga Granti” nënkupton mallrat, punët dhe shërbimet e lidhura me to, të nevojshme për Projektin dhe që duhet të financohen nga Granti, siç përshkruhet më tej në pasqyrën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

“Marrëveshja e *by-pass*-it të Vlorës IPA” ka kuptimin e dhënë në pikën C.

“Llogaria e *by-pass*-it të Vlorës IPA” ka kuptimin e dhënë në pikën C.

“Granti i *by-pass*-it të Vlorës IPA” ka kuptimin që i është dhënë në seksionin 2.01 (Monedha e Shumës dhe Qëllimi) në këtë Marrëveshje.

“Data e Fundit e Disponibilitetit të Grantit” nënkupton datën e specifikuar në seksionin 2.02 (a) (Data e Fundit e Disponibilitetit të Grantit) në këtë Marrëveshje.

“Marrëveshja e Huas” ka kuptimin e dhënë në pikën B.

“Financimi i Huas” nënkupton financimin e bërë ose që duhet të vihet në dispozicion nga Banka për Marrësin në cilësinë e tij si Huamarrës, në përputhje me Marrëveshjen e Huas.

“Plani i Prokurimit” nënkupton planin e prokurimit për Projektin, duke përfshirë Objektet e Financuara nga Granti, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, një plan i tillë prokurimi mund të ndryshohet herë pas here nga Marrësi me pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

“Projekti” nënkupton ndërtimin e një *by-pass*-i 29 km në qytetin e Vlorës. Punimet për Projektin, duke përfshirë taksat, do të bashkëfinancohen nga BERZH-i, Banka Evropiane e Investimeve dhe Bashkimi Evropian. Republika e Shqipërisë do të financojë zotërimin e tokës dhe të gjitha taksat.

“Data e Përfundimit të Projektit” nënkupton datën në të cilën kanë ndodhur të gjitha proceset e mëposhtme:

a) Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, do t’i dorëzojë Bankës dhe Këshilltarit për Zbatimin e Projektit, një lajmërim, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i ARRSH-së, i cili vërteton se Projekti është përfunduar;

b) Banka do të marrë një certifikatë nga Këshilltari për Zbatimin e Projektit, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, duke konfirmuar pa asnjë material rezervë, se Projekti është zbatuar; dhe

c) Banka do t’i dorëzojë Marrësit një lajmërim që konfirmon se Banka është e kënaqur se Projekti është përfunduar.



“Këshilltari për Zbatimin e Projektit” nënkupton këshilltarin/ët e angazhuar ose që do të angazhohen nga ARRSH-ja në përputhje me seksionin 3.06 (Këshilltarët) e Marrëveshjes së Huas, për të ndihmuar për zbatimin e Projektit.

“Marrësi” nënkupton Republikën e Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

“Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit” nënkupton ministrin e Financave të Marrësit.

“Angazhimi i Rimbursimit” nënkupton një angazhim të përmendur në seksionin 2.03 (Angazhimet e Kushtëzuara dhe të Pakushtëzuara të Rimbursimit) në këtë Marrëveshje, dhe mund të jetë një “Angazhim i Kushtëzuar i Rimbursimit” ose një “Angazhim i Pakushtëzuar i Rimbursimit”, terma të cilët janë përdorur në këtë paragraf.

“Termat dhe Kushtet Standardë” nënkupton Termat dhe Kushtet Standardë të BERZH-it, të datës 1 dhjetor 2012.

Seksioni 1.02. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

a) fjalët e shkruara në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjellas, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe;

b) titujt dhe tabela e lëndës janë përfshirë vetëm për lehtësi reference dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

c) fjalët e përdorura për persona të caktuar përfshijnë korporata, partneritete dhe subjekte të tjera ligjore, dhe referimi ndaj një personi përfshin pasardhësit dhe drejtëmarrësit e tij të autorizuar; dhe

d) referimi ndaj një neni të caktuar, seksioni, pasqyre ose deklarimi specifik, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në Marrëveshje, do të interpretohet si referim i atij neni të caktuar ose seksioni, shtojce ose deklarimi specifik të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 2

### Financimi i Grantit

Seksioni 2.01. Sasia, monedha dhe qëllimi

a) Në përputhje me këtë Marrëveshje, Banka bie dakord të financojë Marrësin me një grant në një sasi prej 17.000.000 eurosh (shtatëmbëdhjetë milionë euro) (Granti i *by-pass*-it të Vlorës IPA);

b) Granti do të sigurohet nga Banka vetëm për qëllimet e financimit të Objekteve të Financuara nga Granti, të cilat duhet të prokurohen në përputhje me seksionin 3.05 (Prokurimi) të kësaj Marrëveshjeje.

c) Sipas seksionit 5.05 (Rastet e Rimbursimit) të kësaj Marrëveshjeje, Granti është i parimbursueshëm.

d) Konfirmohet dhe bihet dakord shprehimisht se Banka nuk do të detyrohet të bëjë asnjë lloj disbursimi ndaj personave të tretë apo pagesa të llojeve të tjera, në përputhje me këtë Marrëveshje, vetëm në rast se kjo sasi monetare vihet në përdorim në lidhje me Marrëveshjen dhe një disbursim i tillë nën Grantin e *by-pass*-it të Vlorës IPA, është i disponueshëm në llogarinë e *by-pass*-it të Vlorës IPA për këtë qëllim.

Seksioni 2.02. Disbursimet

Në bazë të seksionit 5.01 (Pezullimi), seksionit 5.02 (Anulimi nga Banka) dhe seksionit 7.02 (Kushtet Paraprake për Hyrjen në Fuqi) të kësaj Marrëveshjeje, Granti do të financohet nga Banka herë pas here, në një ose më shumë disbursime, në bazë të dispozitave të mëposhtme:

a) Data e Fundit e Disponibilitetit të Grantit

E drejta e Marrësit për të kërkuar një Disbursim nën Grantin e *by-pass*-it të Vlorës IPA, në përputhje me këtë Marrëveshje, do të bëhet efektive në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe do të përfundojë në Datën e Fillimit: i) të Afatit të Fundit të Disponibilitetit për këstin e dytë të huas, siç përshkruhet në Marrëveshjen e Huas) të specifikuar në seksionin 2.02 (f) (Kushte të Tjera Financiare të Huas) të Marrëveshjes së Huas; ose ii) 30 nëntor 2017; ose në një datë të mëvonshme që Banka, sipas diskrecionit të saj dhe në përputhje me marrëveshjen e Marrësit, mund të vendosë dhe të njoftojë Marrësin.

b) Shpenzimet e pranueshme

Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, Disbursimet do të bëhen vetëm për të financuar:

- shpenzime të bëra në lidhje me kostot e arsyeshme të Zërave të Financuar nga Granti; dhe
- shpenzime të kryera pas datës së kësaj Marrëveshjeje.



## c) Kushtet për Disbursimin

Duke mos kufizuar përgjithësimin e seksionit 2.02 (Disbursimet) e kësaj Marrëveshjeje, çdo Disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me një ose më shumë Zëra të Financuar nga Granti, do t'i nënshtrohet përmbushjes ose sipas diskrecionit të vetëm të Bankës, heqjes dorë, qoftë plotësisht ose pjesërisht dhe në bazë të kushteve ose pa u kushtëzuar nga kushti që në datën e marrjes së kërkesës së Marrësit për disbursim të Transhit B të Huas së Financuar, sipas seksionit 6.04 (Kushtet e Disponibilitetit të Transhit B).

## d) Kërkesa për Disbursim

1. Marrësi mund të kërkojë një Disbursim, duke i dërguar Bankës një kërkesë fillestare për një Disbursim të tillë, të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit ose një palë e tretë e zgjedhur nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit. Çdo kërkesë Disbursimi duhet të jetë në formën e Deklarimit 1 (Formulari i Kërkesës së Disbursimit) dhe duhet t'i dërgohet Bankës brenda (15) pesëmbëdhjetë ditëve pune para afatit të vlefshmërisë së një Disbursimi të tillë. Kjo kërkesë duhet, përveç rasteve të tjera për të cilat Banka bie dakord, të jetë e parevokueshme dhe detyruese për Marrësin.

2. Çdo kërkesë disbursimi duhet të shoqërohet nga dokumente dhe prova ligjore të tjera të mjaftueshme në formë dhe në përmbajtje, për të bindur Bankën se Marrësi është i lejuar ligjërisht për të zotëruar sasinë e Disbursimit, dhe që sasia e Disbursimit do të përdoret ekskluzivisht për Zërat e Financuar nga Granti. Dokumente të tilla duhet të përfshijnë faturat, por jo të kufizohen vetëm te fatura/t e Kontraktorit, të certifikuara nga ose në emër të Marrësit, qoftë në faturën aktuale ose në formën e një certifikate të pavarur, e cila përcakton se mallrat, punët dhe shërbimet e lidhura me to janë kryer apo dërguar në mënyrë të kënaqshme, në përputhje me plotësimin e kërkesave të kësaj Marrëveshjeje dhe kontratës përkatëse.

## e) Monedha e Disbursimeve

Disbursimet do të kryhen në euro në një sasi të barasvlershme për shpenzime që duhet të financohen nga të ardhurat e Grantit. Në rastin e shpenzimeve të kryera në një monedhë/a të ndryshme nga euro, sasia e barasvlershme e Disbursimit do të përcaktohet si më poshtë:

1. nëse Marrësi kërkon një pagesë në euro, Banka do të përcaktojë sasinë e barasvlershme të Disbursimit pas pagesës;

2. nëse Marrësi kërkon një pagesë në monedhën /at e shpenzimeve të kryera, duke marrë parasysh se shpenzime të tilla janë në monedhë/a lehtësisht të disponueshme nga Banka, kjo e fundit do të blejë sasinë e kërkuar të monedhës/ve në një mënyrë që Banka e konsideron të përshtatshme. Sasia e barasvlershme e Disbursimit do të përcaktohet nga Banka në bazë të kostove të këmbimit valutor, kosto e cila shlyhet ose do të shlyhet nga Banka, duke përdorur monedhën euro për të plotësuar kërkesën.

## f) Pagesat në monedha të tjera

Në raste të veçanta, Banka mund të plotësojë një kërkesë të Marrësit që pagesat të kryhen në një monedhë/a të ndryshme nga euroja ose të ndryshme nga monedha e zgjedhur për të kryer shpenzimet. Në këtë rast, Banka do të blejë një sasi të tillë monetare në monedhën/at e përzgjedhura në mënyrë të tillë që Banka e konsideron të arsyeshme. Sasia e barasvlershme e Disbursimit do të përcaktohet nga Banka në bazë të kostove të këmbimit valutor, kosto e cila shlyhet ose do të shlyhet nga Banka duke përdorur monedhën euro për të plotësuar kërkesën.

## g) Sasia Minimale e Disbursimit

Përveç pagesës së fundit të Disbursimit ose rasteve të veçanta për të cilat Banka bie dakord, Disbursimi do të kryhet në sasi jo më pak se 250.000 euro.

h) Përfaqësuesi i Autorizuar për Kërkesat për Disbursim

Ministri i Financave i Marrësit është përcaktuar si Përfaqësuesi i Autorizuar, i cili synon të ndër marrë veprimet e kërkuara apo të lejuara sipas kushteve të siguruara në këtë seksion 2.02 ose në seksionin 2.03 më poshtë.

## i) Raporti

Sasia e plotë monetare e Grantit të *by-pass*-it të Vlorës IPA, e disbursuar nga Banka (duke përfshirë sasinë e Grantit të përdorur me qëllim plotësimin e pagesave që i nevojiten Bankës për nevojat e menaxhimit), nuk duhet të tejkalojë 48.57% të sasisë totale të disbursuar nën këtë Marrëveshje dhe nën Transhin B të marrëveshjes së huas.



Seksioni 2.03. Angazhimet për Rimbursimin e Kushtëzuar dhe të Pakushtëzuar

a) Në bazë të kërkesës së Marrësit, e cila duhet të jetë në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, në përputhje me financimet e përshtatshme nga Libri i Disbursimeve të BERZH-it *mutatis mutandis*, Banka mund të vërë në përdorim Rimbursimet e kushtëzuara ose të pakushtëzuara për të rimbursuar pagesa të kryera nga banka të nivelit të dytë, bazuar në letrat e kreditit në kuadër të shpenzimeve të financuara nga Granti. Çdo rimbursim i tillë do të konsiderohet si një Disbursim.

b) Në rastin e një Angazhimi Rimbursimi të kushtëzuar, detyrimi që ka Banka për të paguar do të pezullohet ose do të përfundojë menjëherë, mbi çdo pezullim apo anulim të Grantit nga Banka në bazë të seksionit 5.01 (Pezullimi) ose seksionit 5.02 (Anulimi nga Banka) të kësaj Marrëveshjeje.

c) Në rastin e një Angazhimi Rimbursimi të pakushtëzuar, detyrimi që ka Banka për të paguar nuk do të ndikohet nga asnjë pezullim i mëvonshëm apo anulim i Grantit.

Seksioni 2.04. Anulimi nga Marrësi

Marrësi mund të anulohet, në jo më pak se tridhjetë (30) ditë pune pas dërgimit të lajmërimit me shkrim për Bankën, pjesërisht apo tërësisht, çdo sasi të padisbursuar të Grantit. Çdo njoftim i tillë nga ana e Marrësit do të konsiderohet i paravokueshëm dhe detyruar për Marrësin.

Seksioni 2.05. Pagesat

a) Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, shumat për t'u disbursuar nga Banka sipas kësaj Marrëveshjeje, do të paguhet drejtpërdrejt në llogarinë e Kontraktorit të zgjedhur, siç kanë përcaktuar nënshkruesit e autorizuar të Marrësit në kërkesën e Disbursimit.

b) Nëse data e detyruar për ndonjë pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bie në një datë që nuk është ditë pune, atëherë pagesa do të kryhet në ditën e mëpasshme të punës.

c) Çdo shumë që mund të bëhet e kërkueshme për Bankën sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet, pa kompensim ose kundërkërkesë në euro, për vlerën në datën e caktuar, në llogaritë në Londër, Angli ose vende të tjera që Banka mund

të caktojë herë pas here me anë të një njoftimi për Marrësin.

Neni 3

### Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01

a) Bashkëpunimi dhe informacioni

Dispozitat e seksioneve 4.01 (a) dhe 4.02 (b) (Bashkëpunimi dhe Informacioni) të Termave dhe Kushteve Standardë do të zbatohen sikur të ishin përcaktuar plotësisht në *mutatis mutandis*, duke përfshirë, pa cenuar përgjithësimin e këtyre kushteve të Marrëveshjes, si më poshtë:

i) referencat ndaj “Huamarrësit” interpretohen si referenca ndaj “Marrësit”;

ii) referencat ndaj “Huas” interpretohen si referenca ndaj “Grantit”; dhe

iii) referencat ndaj “Marrëveshjes së Huas” interpretohen si referenca ndaj “kësaj Marrëveshjeje”.

b) Pas marrjes së këtij informacioni në bazë të Marrëveshjes së Huas, Banka mund të përdorë dhe të mbështetet në një informacion të tillë në cilësinë e saj si ofruese e Grantit, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Përgjegjësitë që lidhen me kryerjen e Projektit

a) Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, përveç rasteve të tjera për të cilat Banka bie dakord:

1. do të përmbushë projektin me kujdesin e duhur dhe me efikasitet, si dhe në përputhje me Marrëveshjen e Huas dhe këtë Marrëveshje;

2. do të përmbushë projektin në përputhje me Planin e Prokurimit, i cili mund t'iu nënshtrohet ndryshimeve për të cilat Banka bie dakord nëpërmjet një njoftimi me shkrim;

3. do të përmbushë Projektin në përputhje me Planin e Veprimtimit Mjedisor dhe “Kërkesat e Paracaktuara mbi Përmbushjen”;

4. do të sigurojë se gjatë të gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të Projektit do të jetë funksional një ekip për zbatimin e Projektit, me të gjitha burimet e duhura dhe personel të përshtatshëm e të kualifikuar, sipas termave të referencës, të pranueshëm për Bankën;

5. do të bëjë të mundur që data e përfundimit të Projektit të jetë jo më vonë se 31 dhjetor 2017; dhe



6. do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar përmbushjen me sukses të Projektit.

b) Dispozitat e paragrafëve 4.02 (d) dhe 4.02 (f) (Përgjegjësitë e Lidhura me Ekzekutimin e Projektit) të Termave dhe Kushteve Standardë do të zbatohen sikur të ishin përcaktuar në të plotësisht, *mutatis mutandis*, duke përfshirë, pa cenuar përgjithësimin e kushteve të Marrëveshjes, si më poshtë:

i) referencat ndaj “Huamarrësit” interpretohen si referenca ndaj “Marrësit”; dhe

ii) referencat ndaj “të ardhurave të Huas” interpretohen si referenca ndaj “Grantit”.

Seksioni 3.03. Përputhshmëria mjedisore dhe sociale

Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, duhet të sigurojë që pjesa e Projektit e financuar nga Granti të kryhet në përputhje me seksionin 3.05 (Marrëveshjet për Përputhshmërinë Mjedisore dhe Sociale) të Marrëveshjes së Huas.

Seksioni 3.04. Ekipi për Zbatimin e Projektit

Marrësi nëpërmjet ARA-s, duhet të sigurojë që aktivitetet dhe përgjegjësitë e PIT-it, të referuara në seksionin 3.03 (Ekipi për Zbatimin e Projektit) të Marrëveshjes së Huas, do të përfshijnë prokurimin e Zërave të Financuar nga Granti dhe zbatimin e Grantit.

Seksioni 3.05. Prokurimi

a) Prokurimi i Zërave të Financuar nga Granti, përveç rasteve të tjera për të cilat Banka bie dakord, do të rregullohet sipas Rregullave të Prokurimit të BERZH-it. Zërat e Financuar nga Granti do të prokurohen nëpërmjet një tenderi të hapur siç është përcaktuar në kapitullin 3 të Rregullave të Prokurimit të BERZH-it.

b) Të gjitha kontratat u nënshtrohen procedurave të shqyrtimeve paraprake, siç është përcaktuar në Rregullat e Prokurimit të BERZH-it.

Seksioni 3.06. Të dhënat e Projektit dhe raportet; analizat

a) Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, do të sigurojë që informacioni i dërguar Bankës nga Marrësi nëpërmjet ARRSH-së, si dhe të dhënat e ruajtura nga Marrësi nëpërmjet ARRSH-së, të jetë në përputhje me detyrimet e Marrësit, në cilësinë e tij si Huamarrës, në përputhje me seksionin 3.07 (Shpeshësia e Raportimeve dhe Kërkesat për

Parashtrime) të Marrëveshjes së Huas, seksionin 4.01 (Të Dhënat Financiare dhe Raportet) dhe seksionin 5.02 (Raportimi) të Termave dhe Kushteve Standardë:

1. përfshin informacion të detajuar në lidhje me Kontratën, Kontraktorët, Disbursimet dhe Grantin e përdorimit të tij, Zërat e Financuar nga Granti, si dhe në lidhje me statusin e rënies dakord me secilën nga pikat e përfshira në këtë Marrëveshje, në formë dhe në përmbajtje, të pranueshme për Bankën;

2. përfshin informacion të nevojshëm për të bërë të mundur ndjekjen e mënyrës së përdorimit të Grantit nga Financimi i Huas;

3. përfshin informacion të lidhur me “ndër të tjera” dhe me Marrësin, Projektin dhe me të gjitha transaksionet që përmban kjo Marrëveshje, për të cilat Banka mund të drejtojë kërkesë herë pas here.

b) Marrësi do t’i japë Bankës (nëse Banka kërkon diçka të tillë, certifikuar nga një nëpunës i autorizuar i Marrësit), sa më shpejt të jetë e mundur, megjithatë jo më parë se tridhjetë (30) ditë nga përmbushja e kontratës së fundit, me një raport përfundimtar në lidhje me përdorimin e Grantit, i cili do të specifikojë hollësisht të gjitha Kontratat, Kontraktorët, Zërat e Financuar nga Granti, pasqyrat e shpërndarjes dhe ngritjes, si dhe një krahasim me parashikimin fillestar.

c) Marrësi do t’i japë Bankës (nëse Banka kërkon diçka të tillë, certifikuar nga një nëpunës i autorizuar i marrësit) sa më shpejt të jetë e mundur, megjithatë jo më parë se tridhjetë (30) ditë nga përmbushja e kontratës së fundit, një raport përfundimtar që përshkruan dhe identifikon përdorimin e Grantit.

d) Marrësi do të bëjë të mundur për Bankën, Donatorin dhe përfaqësuesit e tyre, me kërkesën e Bankës:

1. të vizitojë ndërtesat dhe sheshet e ndërtimit që lidhen me Projektin;

2. të ekzaminojë të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e lidhura me to të financuara nga Granti dhe çdo impiant, instalim, vend, punim, ndërtesë, pronë, pajisje, të dhënë dhe dokument që lidhet me performancën dhe detyrimin e Marrësit nën këtë Marrëveshje;

3. për këto qëllime të takojnë dhe të diskutojnë me përfaqësuesit dhe punonjësit e Marrësit në



një mënyrë që Banka e konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme.

e) Pas dhënies së kontratës, Banka mund të publikojë një përshkrim, i cili mund të përmbajë emrin dhe shtetësinë e Kontraktorit, si dhe çmimin e kontratës.

f) Marrësi do të bëjë të mundur për Bankën, Donatorin dhe Përfaqësuesit e tyre, akses në librat e llogarive dhe të dhënat e Marrësit të lidhura me Projektin dhe Grantin.

Seksioni 3.07. Vizibiliteti

a) Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, do të ndërmarrë masat e duhura për të publikuar në publikimet përkatëse, komunikimet, si dhe në media, faktin që Projekti ka marrë fonde nga “ndër të tjera”: Bashkimi Evropian.

b) Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, duhet të përfshijë në të gjithë materialin e tij promocional të lidhur me Projektin, një referencë për faktin se Projekti është financuar dhe mbështetur nga Bashkimi Evropian, në përputhje me udhëzimet e fundit të Bashkimit Evropian për Vizibilitetin, të cilat janë të disponueshme në faqen e Internetit: [http://ec.europa.eu/evropeaid/work/visibility/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/evropeaid/work/visibility/index_en.htm)

Neni 4

### **Marrëveshjet Financiare dhe Operacionale**

Seksioni 4.01. Të Dhënat Financiare dhe Raportet

a) Marrësi duhet të sigurojë se ARRSH-ja do të ruajë të dhënat dhe llogaritë, veçmas në lidhje me Grantin, në përputhje me standardet e kontabilitetit, të pranueshme nga Banka dhe të zbatueshme në mënyrë të vazhdueshme.

b) Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, do të sigurojë se informacioni i dhënë ndaj Bankës dhe të dhënat e ruajtura nga ARRSH-ja janë në përputhje me detyrimet e Marrësit në cilësinë e tij si Huamarrës, sipas seksionit 4.01 (Të Dhënat dhe Raportimet Financiare) të Marrëveshjes së Huas, si dhe seksionit 5.02 (c) (i) (Raportimi) të Rregullave dhe Kushteve Standardë:

1. përfshin informacion të detajuar në lidhje me Grantin dhe përdorimin e tij, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën;

2. përfshin informacion të nevojshëm për të mundësuar ndjekjen e mënyrës së përdorimit të Grantit nga Financimi i Huas;

3. përfshin informacion në lidhje me të dhënat, llogaritë dhe statuset financiare për të cilat Banka mund të drejtojë herë pas here kërkesë të arsyeshme.

c) Marrësi, nëpërmjet ARRSH-së, deri të paktën pesë (5) ditë pas datës së përfundimit të Projektit, do të kryejë detyrat e mëposhtme:

1. të mbajë dokumentet e llogarive dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e financuara nga Granti; si dhe

2. t'i vërë në dispozicion Bankës dhe/ose Donatorit, sipas kërkesës, të gjithë informacionin financiar, duke përfshirë statusin e llogarive, në lidhje me Projektin.

Seksioni 4.02. Kryerja e Biznesit dhe e Operacioneve

Përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, Marrësi bie dakord që:

a) do të përmbushë sipas rregullave të gjitha detyrimet e tij nën këtë Marrëveshje në cilësinë e tij si Marrës, sipas Marrëveshjes së Huas;

b) do të ekzekutojë çdo dokument tjetër dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet që Banka i përcakton si të nevojshme ose të dëshirueshme për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03. Taksat

a) Marrësi do të paguajë, sipas kërkesës, të gjitha taksat e vendosura dhe të pagueshme, në lidhje me ekzekutimin, publikimin, shpërndarjen, regjistrimin ose noterizimin e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë ofrimin nga Granti) ose çdo dokument tjetër që ka lidhje me këtë Marrëveshje.

b) Asnjë pjesë e të ardhurave të Grantit nuk do të përdoret, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për pagesën e taksave, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo diku tjetër.

Seksioni 4.04. Mashtrimi dhe Korrupsioni

Marrësi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga nëpunësit e tij, drejtuesit, punonjësit e autorizuar, agjentët dhe përfaqësuesit ligjorë, që të përfshihen në lidhje me Projektin, Grantin dhe transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje, në asnjë Praktikë të Ndaluar.

Neni 5

### **Pezullimi dhe anulimi: Rimbursimi**

Seksioni 5.01. Pezullimi

a) Nëse ndonjë nga rastet e mëposhtme do të ndodhë apo vazhdojë, Banka mund të pezullojë, pjesërisht apo tërësisht, pas





lajmërimin nga Marrësi, të drejtën e Marrësit për çdo Disbursim të mëvonshëm sipas kësaj Marrëveshjeje:

1. Marrëveshja e Huas nuk është më në fuqi dhe efekt të plotë ose ka përfunduar.

2. Marrësi nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose në cilësinë e tij si Marrës nën Marrëveshjen e Huas.

3. Banka ka pezulluar ose një ngjarje e caktuar ka ndodhur dhe i ka dhënë të drejtën Bankës për të pezulluar, pjesërisht apo tërësisht, të drejtën e Marrësit në cilësinë e tij si Marrës për të kryer tërheqjen e fondeve, sipas seksionit 7.01 (Pezullimi) të Termave dhe Kushteve Standardë ose sipas seksionit 5.01 (Pezullimi) të Marrëveshjes së Huas.

4. Banka ka anuluar ose një ngjarje e caktuar ka ndodhur dhe i ka dhënë të drejtën Bankës për të anuluar, pjesërisht apo tërësisht, Financimin e Huas sipas seksionit 7.02 (Anulimi) të Termave dhe Kushteve Standardë.

5. Një Rast Përshpejtimi në Marrëveshjen e Huas dhe/ose në Termat dhe Kushtet Standardë ka ndodhur ose po vijon, dhe Banka ka deklaruar se e gjitha ose një pjesë e financimit të Huas duhet të jetë e gatshme dhe e pagueshme sipas seksionit 7.06 (Rastet e Përshpejtitimit) të Termave dhe Kushteve Standardë.

6. Ka lindur një situatë e jashtëzakonshme si pasojë e ngjarjeve të ndodhura, të cilat kanë sjellë një pamundësi të vazhdimin të Projektit ose të aftësisë së Marrësit për përmbushjen e detyrimeve të tij nën këtë Marrëveshje.

7. Marrëveshja e *by-pass*-it të Vlorës IPA ka përfunduar sipas një njoftimi të dhënë më parë.

8. Një përfaqësim i bërë nga Marrësi në lidhje me këtë Marrëveshje ka pasur parregullsi apo paqartësi në ndonjë material përkatës.

9. Marrësi, në cilësinë e tij si Huamarrës, ka anuluar pjesërisht apo tërësisht, ndonjë pjesë të padisbursuar të financimit të Huas sipas seksionit 3.08 (Anulimi) të Termave dhe Kushteve Standardë; ose

10. Marrësit ose ndonjë prej zyrtarëve të tij, nëpunësve, punonjësve, oficerëve, agentëve apo përfaqësuesve ligjorë, i është hapur një proces gjyqësor apo hetim zyrtar, për shkak të përfshirjes në ndonjë Praktikë të Ndaluar.

b) E drejta e Marrësit për të përfituar Disbursim të mëtejshëm do të vazhdojë të jetë e pezulluar, pjesërisht apo tërësisht, deri kur rasti apo rastet të cilat sollën pezullimin, të pushojnë së ekzistuari; përveçse nëse Banka ka njoftuar Marrësin se e drejta për disbursime të mëvonshme është rifituar; megjithatë e drejta për disbursime të mëtejshme do të rifitohet vetëm sipas kushteve të specifikuar në një njoftim të tillë dhe asnjë njoftim i këtij lloji nuk do të ndikojë apo dëmtojë të drejtën, fuqinë ose kufirin e veprimtarisë të Bankës në lidhje me çdo rast tjetër që mund të ndodhë, të përshkruar në këtë seksion.

Seksioni 5.02. Anulimi nga Banka

a) Kurdoherë që banka përcakton, pas këshillimit me Marrësin, se një sasi e Grantit nuk kërkohet për të financuar koston e Projektit, kostoja e cila financohet jashtë Grantit, pasi ka njoftuar Marrësin, Banka mund të anulojë këtë sasi të Grantit. Në Datën e fundit të Disponibilitetit të Grantit, çdo sasi e padisbursuar e Grantit do të anulohet automatikisht, përveç rasteve të tjera për të cilat Banka bie dakord.

b) Nëse e drejta e Marrësit për Disbursim të çdo pjese të Grantit në këtë Marrëveshje është pezulluar sipas seksionit 5.01 (Pezullimi) të kësaj Marrëveshjeje për një periudhë të pandërprerë prej tridhjetë (30) ditësh, pasi ka njoftuar Marrësin, Banka mund të anulojë Grantin, pjesërisht apo plotësisht.

c) Nëse Banka ka anuluar ose ka ndodhur një rast i cili i ka dhënë të drejtën Bankës për të anuluar, pjesërisht apo plotësisht, Financimin e Huas sipas seksionit 7.02 (Anulimi) të Termave dhe Kushteve Standardë, pasi ka njoftuar Marrësin, Banka mund të anulojë Grantin, pjesërisht apo plotësisht.

d) Në çdo rast, Banka përcakton se:

1. prokurimi i secilit nga Zërat e Financuar nga Granti nuk është në përputhje me Marrëveshjen;

2. fondet e disbursuara nën këtë Marrëveshje janë përdorur për qëllime të ndryshme nga qëllimet që kërkon Marrëveshja;

3. në lidhje me ndonjë kontratë, ndonjë përfaqësues i Marrësit ose Kontraktor është përfshirë ose ka pasur lidhje me Praktikën e Ndaluar gjatë prokurimit ose zbatimit të një



kontrate të tillë, dhe Marrësi nuk ka ndërmarrë në kohë veprimet e përshtatshme e të pranueshme për Bankën për përmirësimin e situatës.

Pasi ka njoftuar Marrësin, Banka mund të anulojë Grantin, pjesërisht apo tërësisht. Një anulim i tillë hyn në fuqi kur i jepet njoftimi Marrësit.

e) Kurdo që Banka përcakton se ndonjë përfaqësuesi të Marrësit ose Kontraktori i është hapur një proces gjyqësor apo hetim zyrtar, për shkak të përfshirjes në ndonjë lloj të Praktikës së Ndaluara, pasi ka njoftuar Marrësin, Banka mund të anulojë Grantin, pjesërisht apo tërësisht. Një anulim i tillë hyn në fuqi kur i jepet njoftimi Marrësit.

Seksioni 5.03. Angazhimet e rimbursimeve të pakushtëzuara që nuk ndikohen nga Pezullimi apo Anulimi

Asnjë anulim apo pezullim nuk do të zbatohet për sasi të monetare që u nënshtrohen Angazhimeve të Rimbursimeve të Pakushtëzuara, të lidhura nga Banka sipas seksionit 2.03 (Angazhimet për Rimbursimin e Kushtëzuar dhe të Pakushtëzuar) të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në këtë angazhim.

Seksioni 5.04. Detyrimet e Marrësit

Me gjithë anulimet apo pezullimet, të gjitha pikat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë në fuqi të plotë dhe efekt të, përveç rasteve specifike të paraqitura në Marrëveshje.

Seksioni 5.05. Rastet e rikthimit të fondeve

Nëse ndonjë nga rastet e mëposhtme do të ndodhin dhe do të vazhdojnë të ndodhin për një periudhë të përcaktuar më poshtë, atëherë në çdo kohë gjatë vazhdimit të kësaj ngjarjeje, pasi ka njoftuar Marrësin, Banka mund të kërkojë nga Marrësi rikthim të plotë ose të pjesshëm të Grantit (dhe të paguajë sasi të tjera të pagueshme nën këtë Marrëveshje) dhe e njëjta sasi do të bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme menjëherë (megjithatë, asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të kundërshtojë pikat më poshtë):

a) Ka ndodhur ndonjë ngjarje e specifikuar në seksionin 5.01(a) (1) (Pezullimi) në këtë Marrëveshje;

b) Ka ndodhur ndonjë ngjarje e specifikuar në seksionin 5.01(a) (2) (Pezullimi) në këtë Marrëveshje dhe, nëse ka pasur mundësi për mjet

ligjor, ka vazhduar për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit të dhënë nga Banka;

c) Ndonjë ngjarje përsheptimi e specifikuar në Marrëveshjen e Huas dhe në Termat dhe Kushtet Standardë ka ndodhur ose vazhdon të ndodhë, Banka deklaron se një pjesë apo i gjithë Financimi i Huas do të bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm sipas seksionit 7.06 (Ngjarjet e Përsheptimit) të Termave dhe Kushteve Standardë;

d) Kurdo që Banka përcakton se ndonjëri nga përfaqësuesit e Marrësit ose ndonjë Kontraktori i është hapur proces gjyqësor ose hetim zyrtar për shkak të përfshirjes në Praktikën e Ndaluara;

e) Marrësi, në cilësinë e tij si Marrës, ka anuluar, pjesërisht apo tërësisht, çdo sasi të padisbursuar të financimit të Huas sipas seksionit 3.08 (Anulimi) të Termave dhe Kushteve Standardë.

Neni 6

### Zbatueshmëria, Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Seksioni 6.01. Zbatueshmëria

Të drejtat dhe detyrimet e Marrësit do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht ligjeve vendore që mund të jenë në kundërshtim me to. Marrësit, në asnjë rrethanë, nuk do t'i lejohet të paraqesë ankesa se pika të kësaj Marrëveshjeje janë të pavlefshme apo të pazbatueshme për çfarëdolloj arsyeje.

Seksioni 6.02. Dështimi në ushtrimin e të drejtave

Asnjë vonesë në ushtrimin e të drejtave apo pamundësi për ushtrimin e të drejtave, fuqive apo mjeteve të tjera ligjore që i takojnë dhe ndikojnë te pala tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje, do ta dëmtojë këtë të drejtë, fuqi apo mjet ligjor ose të konsiderohet si heqje dorë ose pranim në heshtje i kësaj të drejte; as veprimi i një pale të tillë në lidhje me ndonjë mospërmbushje, do të ndikojë ose do të dëmtojë këto të drejta, fuqi apo mjete ligjore të kësaj pale në lidhje me mosplotësimet e mëtejshme.

Seksioni 6.03. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Dispozitat e seksionit 8.04 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) të Termave dhe Kushteve Standardë do të zbatohen si të mirëpërcaktuara mutatis mutandis, pa ndërhyrë në përgjithësimin e tyre, si më poshtë:



i) Referencat ndaj “Marrëveshjes së Huas”, “Marrëveshjes së Garancisë” ose “Marrëveshjes së Projektit” interpretohen si referenca ndaj “kësaj Marrëveshjeje”;

ii) Referencat ndaj “Marrësit të Huas” interpretohen si referenca ndaj “Marrësit”.

#### Neni 7

### Hyrja në fuqi; përfundimi

Seksioni 7.01. Data e hyrjes në fuqi

Përveç rasteve kur Banka dhe Marrësi bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e vendosur nga Banka, datë për të cilën Marrësi njoftohet se Banka ka pranuar dhe ka verifikuar të dhënat e kërkuara nga seksioni 7.02 (Kushtet që i paraprijnë Hyrjes në fuqi) dhe seksioni 7.03 (Opinionet Ligjore) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.02. Kushtet paraprake të hyrjes në fuqi

Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Banka të jetë e bindur se asnjë nga rastet e referuara në seksionin 5.01 (a) (Pezullimi) ose seksionin 5.02 (Rastet e Rikthimit të fondeve) nuk ka ndodhur apo nuk po ndodh, dhe derisa kushtet e mëposhtme të plotësohen, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën ose në fshehtësi të plotë në rast se Banka heq dorë, pjesërisht ose plotësisht, dhe nëse janë subjekte të kushtëzuara apo të pakushtëzuara:

a) Banka duhet të ketë marrë dy kopje origjinale, të nënshkruara siç duhet, të kësaj Marrëveshjeje;

b) Të gjitha kushtet paraprake për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huas sipas seksionit 9.02 (Kushtet paraprake të hyrjes në fuqi) të Termave dhe Kushteve Standardë, si dhe seksionit 6.04 (kushtet e Disponibilitetit të Transhit B) të Marrëveshjes së Huas, të jenë përmbushur, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën;

c) Banka duhet të ketë marrë të dhëna në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, të cilat tregojnë se nënshkrimi dhe dërgimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Marrësit është plotësisht i autorizuar ose i miratuar nga të gjitha aktet ligjore të nevojshme qeveritare dhe administrative;

d) Banka duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me dokumente të tjera të tilla, sipas kërkesave të saj të arsyeshme.

Seksioni 7.03. Opinionet ligjore

Si pjesë të provave që duhet të jepen sipas seksionit 7.02 (Kushtet paraprake të hyrjes në fuqi) të kësaj Marrëveshjeje, Marrësi duhet të japë ose të marrë masa për t'i dhënë Bankës një opinion në emër të Marrësit nga ministri i Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë ose ndryshe nga Drejtori i Legjislacionit të Ministrisë së Financave, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe që përcakton se Marrëveshja është e autorizuar ose e miratuar sipas rregullave, dhe nënshkruhet dhe shpërndahet në emër të Marrësit, dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërisht detyrues të Marrësit, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 7.04. Përfundimet si pasojë e moshyrjes në fuqi

Nëse kjo Marrëveshje nuk do të ketë hyrë në fuqi deri në datën e cila është nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike nga data e kësaj Marrëveshjeje, të gjitha detyrimet e Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje do të përfundojnë, nëse Banka, pas vlerësimit të arsyeve të vonësës, nuk vendos një datë të mëvonshme për qëllime të këtij seksioni. Banka do të njoftojë menjëherë Marrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 7.05. Përfundimi si pasojë e performancës

a) Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi derisa Marrësi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet përkatëse në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes të paraqitura më sipër, nëse Marrëveshja nuk ka përfunduar më parë në përputhje me rregullat e saj; me kusht që dispozitat e seksionit 6.03 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve) do të mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

b) Pavarësisht nga ndonjë element në kundërshtim me këtë Marrëveshje, dispozitat e seksionit 5.05 (d) (Rastet e Rikthimit të fondeve) do të mbeten në fuqi edhe pas mbylljes së kësaj Marrëveshjeje për pesë (5) vjet pas Datës së Përfundimit të Projektit.



## Neni 8 Të ndryshme

### Seksioni 8.01. Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i kërkuar ose që lejohet të jepet ose që bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të jetë me shkrim. Përveç kur mund të përcaktohet ndryshe në seksionin 7.01 (Data e hyrjes në fuqi) të kësaj Marrëveshjeje, një njoftim i tillë ose kërkesë konsiderohet se është dhënë në mënyrë të rregullt, nëse i është dorëzuar palës që i drejtohet në adresën e specifikuar më poshtë ose në çfarëdo adrese tjetër të cilën mund ta ketë dhënë pala tjetër me shkrim, duke dhënë njoftim përkatës.

Përveç kur mund të përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje ose në Manualin e Disbursimit të BERZH-it, një dorëzim i tillë mund të bëhet dorazi, me postë ose me faks. Dorëzimet e bëra me faks duhet të konfirmohen edhe me postë.

Për Marrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë,  
Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Faks: +355 4 222 8494

Për Bankën:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe  
Zhvillim

One Exchange Square,

London EC2A 2JN, Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Departamentit të  
Administrimit të Operacioneve

Faks: +44 20 7338 6100

### Seksioni 8.02. Autoriteti për të vepruar

Çdo lloj veprimi i kërkuar apo i lejuar, si dhe çdo dokument i kërkuar ose që lejohet të ekzekutohet sipas kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi, do të merret apo ekzekutohet nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit ose nga çdo zyrtar tjetër i Marrësit që mund të caktohet me shkrim nga ky Përfaqësues i Autorizuar. Marrësi duhet t'i japë Bankës të dhënat e autoritetit dhe modelet e nënshkrimit të zyrtarëve të autorizuar, kryesisht sipas pasqyrës 2 (Forma e Letrës së Caktimit të Nënshkrimeve të Autorizuara).

### Seksioni 8.03. Amendimi

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me anë të pëlqimit me shkrim të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Marrësit dhe nga një zyrtar i autorizuar nga Banka.

### Seksioni 8.04. Gjuha angleze

Kjo Marrëveshje është përgatitur dhe do të kryhet në gjuhën angleze. Të gjitha dokumentet e dorëzuara në përputhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë në gjuhën angleze. Dokumentet në gjuhë të tjera duhet të shoqërohen nga një përkthim në anglisht të certifikuar dhe përkthim të miratuar dhe ky përkthim i miratuar është i formës përfundimtare.

### Seksioni 8.05. Zhdëmtimi

a) Marrësi merr përsipër përgjegjësinë e plotë dhe bie dakord dhe duhet të dëmshpërblejë dhe të ruajë Bankën dhe zyrtarët, drejtorët, punonjësit, agjentët dhe kontraktorët e saj të pacenuar ndaj çdo lloj ankese, dëmtimi, kostosh, shpenzimesh, përgjegjësish, procedimeve, humbjeve (me natyrë kompensimi, ndëshkimi ose të çdo lloji), penaliteteve, ankesave, veprimeve, taksave, padive, kostove dhe shpenzimeve (përfshirë kosto të arsyeshme të këshillimit ligjor, si dhe kostove dhe shpenzimeve të hetimit) të çdo lloji natyre, duke përfshirë pa përjashtim dhe paragjykim nga sa është deklaruar përgjithësisht këtu, ato detyrime që lidhen me gabimet në kontratë (përfshirë neglizhencën) ose përgjegjësinë e drejtpërdrejtë ose përgjegjësi të tjera, të cilat zbatohen, kanë lindur ose pohohen kundër Bankës, për secilin nga zyrtarët, drejtorët, punonjësit, agjentët ose nëpunësit (qoftë apo jo të zhdëmtuar nga ndonjë person tjetër sipas këtij dokumenti) dhe që në çfarëdo lloji mënyre kanë lidhje ose lindin, qoftë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë:

1. ndonjë nga transaksionet e parashikuara në këtë Marrëveshje ose gjatë zbatimit, dorëzimit apo kryerjes së saj;

2. funksionimi ose mirëmbajtja e ambienteve të Marrësit ose ato në pronësi, në zotërim apo në kontroll të Marrësit; ose

3. gjatë ushtrimit nga ana e Bankës të ndonjëres nga të drejtat dhe kërkesat, sipas kësaj Marrëveshjeje; si dhe

b) Marrësi pranon që Banka ka hyrë në këtë Marrëveshje dhe ka vepruar si një ofrues granti



dhe jo si këshilltar për Marrësin. Marrësi përfaqëson dhe garanton se, duke hyrë në këtë Marrëveshje, është angazhuar dhe mbështetet në këshillime që i jepen atij nga këshilltarët e vet ligjorë, financiarë dhe profesionistë të tjerë dhe nuk varet apo nuk do të varet në një të ardhme nga këshillat e dhënë prej Bankës.

#### Seksioni 8.06. Caktimet

Marrësi nuk mund të caktojë ose ndryshe të transferojë të gjithë përgjegjësinë ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës.

Seksioni 8.07. Të drejtat, mjetet ligjore dhe heqjet dorë

Të drejtat dhe mjetet ligjore të Bankës, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk cenohen nga asnjë akt ose element që, pavarësisht nga ky seksion, mund të cenojë këto të drejta ose mjete ligjore. Mosdodhja e paraqitjes dhe mosshfaqja e ndonjë vonese në ushtrimin ose mosushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence apo mjeti ligjor nga ana e Bankës, nuk do të cenojë këto të drejta, kompetenca apo mjete ligjore apo të konsiderohen heqje dorë prej saj. Çdo lloj heqjeje dorë nga ndonjë prej termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjes duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga Banka. Në rast se Banka heq dorë nga ndonjë prej kushteve për Disbursim Granti, Marrësi duhet që duke marrë këtë Disbursim, të ketë pranuar dhe të jetë përgjegjës ndaj këtyre kushteve që përcaktohen në këtë akt heqjeje dorë dhe të pranojë në këtë mënyrë automatikisht të drejtën e Bankës që kjo e fundit të kërkojë përputhshmërinë me një kusht të tillë, duke qenë shprehimisht e mbrojtur për qëllimet e Disbursimit pasues. Të drejtat dhe pretendimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshje të tjera plotësuese të saj janë kumulative dhe nuk përjashtojnë të drejtën e ushtrimit apo ndonjë ushtrim të mëtejshëm të saj apo ushtrim të ndonjë të drejte apo mjeti tjetër ligjor.

#### Seksioni 8.08. Zbulimi i informacionit

Banka mund të bëjë publike (nxjerrë) dokumente, informacion dhe të dhëna që lidhen me Marrësin dhe transaksionet e tij (duke përfshirë kopje të kësaj Marrëveshjeje dhe të çfarëdolloj marrëveshjeje plotësuese të saj), nëse Banka e çmon të nevojshme për

qëllime apo që mund të ketë lidhje me ndonjë mosmarrëveshje që përfshin Marrësin për qëllimet e ruajtjes apo të shtrëngimit për zbatim të ndonjë nga të drejtat e Bankës, sipas kësaj Marrëveshjeje ose të çfarëdolloj marrëveshjeje plotësuese të saj ose për grumbullimin e ndonjë shume që i përket Bankës apo për qëllimet e raportimit të Donatori.

Seksioni 8.09. Kopjet origjinale të kësaj Marrëveshjeje

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në tri kopje origjinale.

Në dëshmi sa më sipër, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre zyrtarë të autorizuar, kanë hartuar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze, e cila do të nënshkruhet në tri kopje, në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Nga: \_\_\_\_\_

Emri: Shkëlqim Cani

Titulli: Ministër i Financave

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga: \_\_\_\_\_

Emri:

Titulli:

Me respekt

Për dhe në emër të:

Nga: \_\_\_\_\_

Emri:

Titulli:

### SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E LETRËS SË KAKTIMIT TË NËNSHKRIMEVE TË AUTORIZUARA

- Autorizimi i mësipërm duhet nënshkruar në emër të Marrësit ose Ministrisë nga Përfaqësuesi i saj i Autorizuar. [Lutemi, vini re, se, në lidhje me ndonjë veprim të kërkuar ose të lejuar sipas dispozitave të paraqitura në seksionin 2.02 ose 2.03 të Marrëveshjes së Grantit, autorizimi i mësipërm duhet të nënshkruhet në emër të marrësit nga Personi i Autorizuar i Marrësit, siç përcaktohet në seksionin 2.02(h)]:

- Në rast se çdo dokument duhet të nënshkruhet nga më shumë se një zyrtar, letra e autorizimit duhet ta theksojë këtë qartë dhe



fjalë e parë duhet të përshtatet siç duhet. Nëse nënshkruesit e autorizuar janë ndarë në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i një zyrtari nga secili grup, edhe ky fakt duhet të deklarohet qartë.

Datë 9 korrik 2014

#### GRAFIKU 1 - ZËRAT E SHPENZIMEVE QË FINANCOHEN NGA GRANTI

Tabela e treguar në këtë grafik përcakton Zërat e Shpenzimeve të Financuar nga Granti dhe vlerat e alokuara për secilin nga Zërat e Shpenzimeve të Grantit.

	Zërat e financuar nga Granti	Vlerat e alokuara nga Granti në euro	%
1	Punime për ndërtimin e <i>by-pass</i> -it të Vlorës	16,787,500	98,75
2	Tarifat administrative	212,500	1.25
3	<b>TOTALI</b>	<b>17,000,000</b>	<b>100</b>

Shënim. Tarifat administrative do të mbulojnë kostot e menaxhimit dhe të administrimit të Programit IPA, kontributin e kërkuar nga BERZH-i sipas Marrëveshjes IPA për *by-pass*-in Vlorë.

Datë 9 korrik 2014

#### GRAFIKU 2 – PËRSHKRIMI I PROJEKTTI

1. Qëllimi i Projektit është të asistojë Marrësin për ndërtimin e 29 km rrugë (*by-pass*-i) në qytetin e Vlorës.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa A - Përgatitja e projekteve inxhinierike dhe dokumenteve të tenderit.

Këto shërbime janë financuar nga Bashkimi Evropian.

Pjesa B - Ndërtimi i 29 km rrugë (*by-pass*-i) në qytetin e Vlorës.

Punimet për pjesën B, duke mos përfshirë taksat, do të bashkëfinancohen nga EIB-i dhe nga Bashkimi Evropian. Marrësi do të financojë blerjen (marrjen në zotërim) e tokës dhe taksat që lidhen me pjesën B (që u përkasin kontratave të punimeve civile).

Do të caktohet një konsulent për shërbimet e mbikëqyrjes, i cili do të monitorojë zbatimin e punimeve që përfshihen në pjesën B. Këto

shërbime do të financohen nga Bashkimi Evropian.

#### PASQYRA 1 - FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

[Për t'u shtypur me letër  
me kokë të Marrësit]

[data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square

London EC2A 2JN

Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Njesisë të Operacioneve Administrative

Numri i Operacionit nr. 42319 (Komponent i Grantit)

Kërkesë për Disbursim nr. 1

Ref. Marrëveshja e Grantit datë\_\_\_\_, ndërmjet (Marrësit), [ëSovrani] dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

Me këtë dokument ne kërkojmë disbursimin e mëposhtëm në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit të përmendur më sipër:

Monedha e Grantit: USD/euro

Monedha e kërkuar për pagesën: 2

Vlerat e Financuara/monedha: 3

Vlera në datën: 4

E pagueshme të (kujt i paguhet): 5

Udhëzimet për pagesë (Të dhënat bankare kujt i bëhet pagesa):

Emri i Llogarisë së Përfituesit: 6

Numri i llogarisë së Përfituesit: 7

Emri i Bankës së Përfituesit: 8

Adresa e Bankës së Përfituesit: 9

Të dhënat Bankare të Bankës Korrespondente:

Emri i Bankës Korrespondente: 10

Adresa: 11

Emri i Llogarisë: 12

Numri i Llogarisë: 13

Referenca e Pagesës: 14

Me anë të kësaj, vërtetojmë se nuk kemi kërkuar më parë asnjë disbursim nga Granti për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Ne nuk kemi marrë dhe as nuk synojmë të marrim fonde për këtë qëllim nga asnjë burim tjetër apo nga asnjë grant, kredi apo hua.



Mallrat dhe shërbimet që mbulohen nga kjo kërkesë janë kryer apo blerë në përputhje me detyrimet tona, siç është përcaktuar në Marrëveshjen e Grantit dhe Marrëveshjen e Huas; dhe ii) që nuk është vërejtur asnjë ngjarje që të ketë ndikim material dhe negativ tek operacionet tona ose kushtet financiare ose përgjegjësinë tonë për të kryer Projektin ose për të realizuar çdo detyrim sipas Marrëveshjes së Grantit.

Me respekt

[Nënshkrimi/et] për dhe në emër të: 15

Bashkëlidhur - Numri total i fletëve përmbledhëse: 16

- Numri total i dokumenteve: 17

Shënime për plotësimin e kërkesës për Disbursim

1. Përfituesi duhet të numërtojë çdo formular kërkesë. Kërkesa e parë për disbursim granti duhet të mbajë numrin 1, kërkesat pasuese do të numërtohen 2, 3 etj. I takon përfituesit të ruajë numrin e kërkesave për disbursim që ai bën nën një marrëveshje të caktuar granti. Formularët e kërkesës duhet të ndjekin të njëjtin sistem të vendosjes së numrit rendor, edhe nëse janë për një kërkesëpagesë për disbursim të drejtpërdrejtë apo për lëshimin e një premtimi disbursimi. Përdorimi i këtij sistemi numërimi do të shmanjë konfuzionin në rast se formularët dërgohen me postë, me faks më shumë se një herë etj.

2. Lutemi caktoni monedhën e kërkuar për pagesë. Ajo mund të jetë ose monedha e grantit ose monedha në të cilën janë kryer shpenzimet (shihni pikën 3 më poshtë). Përndryshe, në disa rrethana, Banka mund të bjerë dakord të paguajë në një monedhë të tretë, rast në të cilin ajo do të vepronte si agente e Përfituesit që të sigurohet kjo monedhë.

Nëse pagesa e kërkuar është për më shumë se një lloj monedhe, atëherë duhet përgatitur një formular kërkesë i veçantë për secilën monedhë.

3. Vlerat financiare përbëhen nga shpenzimet fillestare, në monedhën fillestare siç përcaktohet hollësisht në fletën përmbledhëse, të llogaritura në përqindjen e duhur të përcaktuar në Marrëveshjen e Grantit për zërat e zbatueshëm të lejueshëm, të financuar nga Granti. Vlera/t e dhëna këtu duhet të jenë në

përputhje me vlerën/at totale sipas seksionit 15 të fletës përmbledhëse.

4. Vlera, në datën e dhënë, është data kur llogaria e BERZH-it debitohet me vlerën e pagueshme sipas disbursimit. BERZH-i nuk mund të garantojë që llogaria e përfituesit do të kreditohet brenda së njëjtës date, meqë kjo varet nga procedurat që zbatohen nga sistemet e pagesës ose nga banka marrëse në vendin e përfituesit. Duhet të jepen të paktën 15 ditë pune nga data kur BERZH-i merr kërkesën dhe datën e kërkuar të vlerës. Do të ishte më e përshtatshme që të mos vendosej një datë e caktuar, por të shkruhet shprehja “sa më shpejt që të jetë e mundur”, në fushën 4. Në këtë rast, BERZH-i do të kryejë pagesën në çdo rast brenda 15 ditësh pune, por sa më shpejt që të jetë e mundur. (Lutemi, vini re se pagesa mund të garantohet vetëm brenda 15 ditëve pune, nëse kërkesa për disbursim është e saktë dhe e plotë.)

5. Disbursimi i duhet paguar Përfituesit. Normalisht, Përfituesi duhet të jetë Kontraktori, por me kusht që Banka të ketë pranuar me shkrim që dokumentacioni bashkëlidhur (shihni fletën përmbledhëse) të jepen të dhënat e plota që Marrësi i Grantit e ka paguar Kontraktorin, atëherë pagesa mund të bëhet te Përfituesi.

6. Emri i llogarisë së Përfituesit në këtë rast do të jetë thjesht emri i atij kujt i bëhet pagesa.

7. Numri i llogarisë së Përfituesit kërkohet në mënyrë që të shmangen vonesat. Në një numër të madh vendesh, bankat nuk pranojnë të kryejnë pagesa nëse në udhëzimet për pagesë nuk është dhënë numri i llogarisë së Përfituesit.

8. Banka e Përfituesit është banka e cila mban llogarinë e Përfituesit. Ju lutemi tregoni emrin e bankës dhe qytetin.

9. Në vend të adresës, duhet dhënë kodi SWIFT.

10. Banka korrespondente e bankës së Përfituesit kërkohet vetëm nëse pagesa kërkohet të kryhet jo në monedhën e vendit ku është vendosur banka e Përfituesit. Në këtë rast, banka korrespondente është ajo bankë, e ndodhur në vendin që i përket monedhës në të cilën kërkohet të kryhet pagesa në të cilën Përfituesi mban një numër llogarie.



11. Në vend të adresës duhet dhënë kodi SWIFT.

12. Në shumicën e rasteve emri i llogarisë së Përfituesit është thjesht emri i bankës së Përfituesit.

13. Emri i llogarisë së Përfituesit është me rëndësi themelore nëse banka e Përfituesit ka më shumë se një llogari me bankën korrespondente ose nëse ajo nuk është anëtare e marrëveshjes SWIFT (Sistemi ndërkombëtar i shlyerjes së pagesave elektronike). Përndryshe, numri është i përdorshëm, por jo i detyrueshëm. Kur zbatohet kodi IBAN (Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare) duhet të shënohet ky kod.

14. Referenca e pagesës që do të kryejë (dërgojë) BERZH-i për pagesën e ndihmon Përfituesin që të identifikojë pagesën. Nëse nuk kërkohet një referencë specifike, BERZH-i do të përmendë emrin e Përfituesit dhe numrin e marrëveshjes.

15. Nënshkrimi. Fleta përmbledhëse e kërkuar duhet të nënshkruhet nga dhe në emër të Përfituesit.

16. Fletët përmbledhëse rendisin të gjitha llojet e dokumentacionit që bashkëlidhen në mbështetje të kërkesës për Disbursim të paraqitur. Nëse ka shumë lloje, këshillohet të përdoret një fletë përmbledhëse e veçantë për secilën kategori dokumenti.

17. Zërat e dokumentacionit për disbursim (kontratat, faturat, dëftesat etj.) duhet të numërtohen dhe të paraqiten në të njëjtin rend, siç tregohet në fletën përmbledhëse. Numri i tyre total duhet të tregohet qartë, në mënyrë që të lehtësohet shqyrtimi nga ana e BERZH-it.

Datë 9 korrik 2014

#### BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Emri i Përfituesit: [1].....Operacionit [3] .....Nr.: [4]  
Granti i (nr. i referencës/emri %)  
Disbursuar  
Data: [2] Fletë Përmbledhëse Zërat  
Nr.: [5]..... Financuar: [6]...

Nr. i zërit	Pëshkrimi i zërit	Nr. dhe data e Kontratës	Emri dhe adresa e Kontraktorit	Pëshkrimi i shkurtër i mallrave, punimeve dhe shërbimeve	Monedha dhe vlera totale e Kontratës	Monedha dhe vlera totale e shpenzimit të lejuar	Vlera e financimit në monedhën e kryerjes së shpenzimit
[7]	[8]	[9]	[10]	[11]	[12]	[13]	[14]

Nënshkrimi TOTALI (monedha)  
[16] ... [15]

#### SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E FLETËS PËRMBLEDHËSE PËR DISBURSIM

1. Emri. Emri i Përfituesit. Ky emër duhet të jetë i njëjtë me emrin në kërkesën për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

2. Data. Data e kërkesës. Kjo datë duhet të jetë e njëjtë me datën në kërkesën për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

3. Numri i operacionit. Ky numër duhet të jetë i njëjtë me numrin në kërkesën për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

4. Numri i kërkesës. Ky është numri i kërkesës për disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

5. Numri i fletës përmbledhëse. Për çdo kërkesë Disbursimi fletët përmbledhëse duhet të numërtohen, duke filluar nga numri 1 dhe numri total i shënuar në Kërkesën për Disbursim, së cilës i përket kjo fletë përmbledhëse.

6. Zërat e Disbursimit që Financohen nga Granti. Ky është lloji i shpenzimit që financohet nga Granti i projektit, i cili duhet të financohet sipas kësaj kërkesë për disbursim. Ju lutem shiheni me kujdes dhe referojuni Marrëveshjes së Grantit për të pasur emrin dhe numrin e referencës të Zërave të Financuar nga Granti, si dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen (për shembull “Zëri i Financuar nga Granti me nr. (3b), pajisje, 60 %”).

Nëse një Kërkesë për Disbursim mbulon shpenzimet e më shumë se një zëri të financuar nga Granti, atëherë duhet të përdoret më shumë se një fletë përmbledhëse për çdo Zë të Financuar nga Granti.

7. Numri i zërit. Të gjitha llojet e dokumenteve (kontratat, faturat, dëftesat etj.) duhet të paraqiten në të njëjtin rend siç tregohet në fletën përmbledhëse. Për të lehtësuar identifikimin, dokumentet duhet të numërtohen, duke filluar me 1, 2, 3 etj., për çdo kërkesë Disbursimi dhe ky numër duhet të shënohet qartë në vetë





dokumentin. Numri total i zërave për numrin total të të gjitha fletëve përmbledhëse është shënuar në formularin e kërkesës për Disbursim.

8. Përshkrimi i zërit. Lutemi përshkruani çdo zë, si për shembull “faturë”, “dëftesë”, “certifikatë inxhinieri”, “përkthim i [...]” etj.

9. Numri rendor dhe data e Kontratës. Rekomandohet që kontratës t’i vendoset një numër i veçantë kur ajo të përgatitet dhe nënshkruhet ndërmjet Përfituesit dhe Kontraktorit. BERZH-i do të përdorë këtë numër për mbajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave të veta. Nëse kontratës nuk i është vënë një numër i veçantë, BERZH-i do të vendosë një numër dhe do të informojë Përfituesin në kohën e miratimit. Nëse Përfituesi nuk e njeh numrin në kohën e plotësimit të fletës përmbledhëse, kjo pjesë do t’i lihet BERZH-it që ta plotësojë vetë.

Data e Kontratës/e urdhrimit të blerjes duhet, gjithashtu, të vendoset në këtë kolonë.

Shënim. E njëjta kontratë mund të paraqitet në më shumë se një kërkesë për Disbursim, nëse livrimi i mallrave, pagesa e punimeve ose shërbimeve (shihni pikën 11) dhe, rrjedhimisht, pagesa për këto mallra etj., bëhet në faza.

10. Emri dhe adresa e Kontraktorit. Emri dhe adresa e homologut të Përfituesit (Kontraktorit) sipas kontratës/urdhrit të blerjes, siç përshkruhet në pikën 6.

11. Përshkrim i shkurtër i mallrave, punimeve ose shërbimeve. Këto mallra, punime ose shërbime duhet të jenë në përputhje me hollësitë e dhëna në Kontratë ose në dokumente të tjera që paraqiten dhe duhet të jenë sipas Zërave të Financuar nga Granti, të përcaktuara në pikën 6.

12. Monedha dhe vlera totale e Kontratës. Vlera e plotë, në monedhën përkatëse, e Kontratës e renditur në pikën 9.

13. Monedha dhe vlera totale e shpenzimeve të pranueshme. Për shpenzimet, vlera totale e të cilave përbën detyrim ose që duhet paguar, në monedhën përkatëse, e mbuluar nëpërmjet faturave dhe dokumenteve të tjera të renditura në pikat 7 dhe 8. Kur ka më shumë se një “zë” për secilin shpenzim (për shembull një faturë, certifikatë ose dëftesë, që të gjitha për të njëjtin shpenzim), të gjithë këta zëra duhet të futen në

klapa dhe në kolonën përkatëse duhet të vendoset vetëm një shumë.

14. Vlera e financimit. Për çdo shumë të renditur në kolonën 13 duhet të jepet një shumë korresponduese në këtë kolonë 14, e llogaritur në bazë përqindjeje sipas deklaramit në 6, që të jetë në përputhje me kategorinë e shpenzimit të kësaj flete përmbledhëse. Vlera e financimit duhet të jetë në monedhën përkatëse të kontratës dhe shpenzimeve (kolonat 12 dhe 13). Kjo mund të jetë ose mund të mos jetë e njëjta me monedhën e huas ose monedhën e pagesës.

15. Totali. Shumat e financimit, sipas renditjes së pikës 14, duhet të mbledhen për të arritur në një shumë totale në monedhën e caktuar. Për kërkesat e drejtpërdrejta për Disbursim, shuma/t totale të paraqitura këtu duhet të jetë/jenë në përputhje me shumën/at e paraqitura në pikën 9 të Formularit të Kërkesës për Disbursim.

17. Nënshkrimi. Fleta përmbledhëse e kërkuar duhet të nënshkruhet nga dhe në emër të Përfituesit. Shihni formularin e Kërkesës për Disbursim në lidhje me kërkesat për nënshkrim.

PASQYRA 2 – FORMULARI I LETRËS  
QË CAKTON NËNSHKRUESIT  
E AUTORIZUAR

[Të shtypet në letërën me kokë të Përfituesit]  
[Data]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim  
One Exchange Square  
London EC2A 2JN  
Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Njësisë së Operacioneve  
Administrative

Lënda: Operacioni nr. 42319 (Komponentët e Grantit)

Letra që cakton nënshkruesit e autorizuar.<sup>1</sup>

I/e nderuar zotëri/zonjë,  
referuar Marrëveshjes së Grantit të datës \_\_\_\_\_ (Marrëveshja e Grantit) [Përfituesi], [Sovrani] dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), lutemi, vini re se një nga personat për të cilët më poshtë jepet modeli i nënshkrimit të tyre, është i autorizuar në emër të

<sup>1</sup> Caktimi mund të ndryshohet nga [Përfituesi/Ministria] në çdo kohë, duke i paraqitur Bankës një letër të re të Caktimit të Nënshkruesve të Autorizuar.



[Përfituesit/Ministrisë] për të nënshkruar [Kërkesat për Disbursim dhe çdo lloj tjetër dokumenti] të kërkuar ose të lejuar për ekzekutim, sipas Marrëveshjes së Grantit të përmendur më sipër.

EMRI \_\_\_\_\_

POZICIONI \_\_\_\_\_

MODELI I NËNSHKRIMIT \_\_\_\_\_

Të gjitha njoftimet e mëparshme që ofronin nënshkrimet e zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar në emër të [Përfituesit/Ministrisë], sipas Marrëveshjes së mësipërme të Grantit konsiderohen të revokuara.

### LIGJ

Nr. 53/2015

## PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9870, DATË 4.2.2008, “PËR STANDARDIZIMIN”, TË NDRYSHUAR<sup>2</sup>

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 shfuqizohet.

b) Në pikën 4, fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëpunësve të DPS-së rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen me Kodin e Punës.”.

Neni 2

Në nenin 14, shkronja “g” shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.5.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9121, datë 28.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

### NDREQJE GABIMI

Në vendimin e KQZ-së nr. 226, datë 7.5.2015 "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 83, datë 25 maj 2015, faqe 4392 :

**Ishte:** OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z.Ardjan Turku.

**Bëhet:** OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj.Voltana Ademi.

<sup>2</sup> Ky ligj është përfshirë me Rregulloren (BE) nr.1025/2012 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012, “Mbi Standardizimin Europian”, që amendon direktivat e Këshillit 89/686/KEE dhe 93/15/KEE dhe direktivat 94/9/KE, 94/25/KE, 95/16/KE, 97/23/KE, 98/34/KE, 2004/22/KE, 2007/23/KE, 2009/23/KE dhe 2009/105/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit dhe që shfuqizojnë vendimin e Këshillit 87/95/KEE dhe vendimin nr.1673/2006/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit. Numër CELEX 32012R1025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr.316, datë 14.11.2012, fq.12-33.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë